

# Fletorja e komunikimit

## (« Cahier de communication »)

Kjo **fletore** është një mjet që favorizon komunikimin midis shkollës dhe familjes.

Mësuesit-et mund të shënojnë atje informacione të shkollës, lidhur me veprimtari të klasës apo me ngjarje të veçanta. Prindërve u transmetohen rregullisht për konsultim dokumente që tregojnë punën e nxënësit (dosje, fletore, etj.). Ato jepen në rubrikën « Documents en consultation jusqu'au \_\_ » (Dokumente për konsultim deri më \_\_).

Nxënësit e shkollës foshnjore nuk kanë detyra shtëpie.

Prindërit e nënshkruajnë fletoren e komunikimit çdo javë. Ata dëshmojnë kështu se kanë marrë dijeni për të. Për komentet e tyre është rezervuar një hapësirë e veçantë, e cila mund të përdoret lirisht si prej prindërve edhe fëmijës. Ajo u mundëson atyre që t'u transmetojnë mësuesve informacione, t'u bëjnë pyetje, t'u tregojnë për ngjarje të jetës familjare, etj.

Për formën, natyrën dhe sasinë e shënimeve të bëra në agjendë duhet të tregohet një vëmendje e veçantë. Dialog lejon komunikimin lidhur me shkollimin e nxënësit, në mënyrën më të plotë e më të hollësishme. Prindërit dhe mësuesit-et mund të kërkojnë takim në çdo kohë. Kërkesa mund të bëhet përmes rubrikës « Demande d'entretien » (Kërkesë takimi).

Ka edhe mënyra të tjera që u mundësojnë prindërve informimin për çka ndodh në shkollë, siç janë seancat e informimit kolektiv.

Çdo klasë apo stabiliment mund të hartojë rregullat e veta të jetës në bashkësi, në harmoni me Ligjin për arsimin e detyrueshëm dhe rregulloren e zbatimit të tij. Këto rregulla ndodhen në faqet 8 e 9 (« Les règles de vie »).

### **Justifikimi i mungesave dhe kërkesa e lejes (« Justification d'absence et demande de congé »)**

Kushtet lidhur me mungesat dhe lejet individuale të nxënësve, si dhe formularët për justifikimin e mungesave dhe për kërkesën e lejeve gjenden në faqen 98 dhe ato pasuese.